



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË REFORMËS TË FINANCAVE PUBLIKE

Konsultimi i dytë me Shoqërinë Civile për hartimin e Planit të Veprimit të OGP 2020-2022_Transparenca Fiskale

30 Shtator, ora 14.00

Takim virtual në WebEx

Konkluzionet që dakortësuam në takimin e dytë, në date 30 Shtator 2020:

Të martën, datë 15 Shtator, ora 14.00 u organizua takimi konsultues me Organizatat e Shoqërisë Civile për të prezantuar njoftimin e procesit dhe punën paraprake për Komponentin e Transparencës Fiskale. Në takim morën pjesë grupi i punës dhe përfaqësues nga disa Shoqata Civile të ftuar, identifikuar sipas listeprezences bashkëlidhur.

Në takim u zhvilluan pikat sipas axhendes së përcaktuar më parë:

1. Njoftim për hartimin e Planit të Veprimit të OGP 2020-2022_Komponenti i Transparencës fiskale-moderuar nga DMRFP;
2. Prezantim i shkurtër i strukturës së komponentit- moderuar nga DMRFP;
3. Prezantim i qëllimit të secilës masë/politikë që propozohet të jetë pjesë e Planit të Veprimit 2020-2020- moderuar nga DMRFP dhe më pas secili anëtar i grupit të punës shpjegoi çfarë objektivit do të ketë secila nga masat e propozuara;
4. Ftesa e OSHC për të sjellë kontribut/propozime- DMRFP ftoi përfaqësuesit e OSHC-ve prezent nëse kishin komente sugjerime dhe për opinionet e tyre. Nga përfaqësuesit prezent nuk kishte ndonjë sugjerim specifik, vetëm përgëzime për MFE në ndërmarrjen e këtij procesi dhe urime për një proces të mbarë.

Si konkluzion para mbylljes së takimit u komunikua për Shoqërinë Civile se do të kete takime të tjera konsultuese në vijim dhe u ftuan për përcjelljen e kontributeve dhe propozimeve që mund të kishin. Gjithashtu u kërkua që të plotësohej pyetsori i publikuar në faqen e OGP-së.